

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarve A.Z. , Sh.K. ,M.K., Sh.D. ,për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK e të akuzuarit A.Z. dhe Sh.K., shkak të veprës penale mbajtja me pronësi të paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-së për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e PTH-DKR në Prishtinë, ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit A.Z. av.Y.O. dhe Sh.B.-R., të ankesave të mbrojtësve të akuzuarit Sh.K., av.B.T. dhe të ankesës të akuzuarit Sh.K., të mbrojtësit të akuzuarit M.K., av.B.N. dhe te mbrojtëses të akuzuarit Sh.D., av.S.M., me prezencën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.N.R., të dëmtuarit, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr. 552/14 të datës 06.07.2016, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.06.02.2017.mori këtë:

A K T G J Y K I M

I:Me aprovimin e pjesërishëm të ankesave të mbrojtësve të akuzuarit A.Z. dhe të ankesave të mbrojtësve të akuzuarit Sh.K., si dhe të vetë ankesës te akuzuarit Sh.K., të mbrojtësit të akuzuarit M.K. dhe te mbrojtëses të akuzuarit Sh.D. edhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.552/14 të datës 06.07.2016, NDRYSHOHET përkitazi me cilësimin juridik, për veprën penale rastet të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, e me afër te përshkruar si në dispozitivin I, të aktgjykimit për të gjithë të akuzuarit janë shpallë fajtor dhe e njëjta vepër penale ri cilësohet në veprën penale rastet të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, ndërsa për të akuzuarin Sh.K. edhe sa i përket vendimin mbi dënimin dhe Gjykata e Apelit për veprën penale rastet të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 15(pesëmbëdhjetë)vite dhe dënimin shqiptuar veprës penale mbajtja me pronësi të

paautorizuar te armeve nga neni 374 par 1 të KPRK, në kohëzgjatje prej 1(një) viti i merë si të vërtetuara dhe për këto vepra penale në bazë të nenit 80 par.2 nën par 2.4 te KPRK-së, ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 15(pesëmbëdhjetë) e 6(gjashtë)muaj e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.08.2010 e tutje, si dhe të akuzuarve iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, në dënimet e shqiptuara unike, për të akuzuarit, A.Z. dhe dënimi i shqiptuar unik në kohëzgjatje prej 20(njëzet) vite, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim prej datës 19.08.2010 e tutje, të akuzuarit M.K., dënimi i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërmëdhjetë) vite, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.08.2010 dhe të akuzuarit Sh.D., dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 14(katërmëdhjetë)vite e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2011, merren si të vërtetuara.

II. Ankesa e PTH-D.K.R në Prishtinë Refuzohet si e pabazuar.

III. Ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.N.R. Hudhet poshtë si e palejuar

IV. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.552/14 të datës 06.07.2016, i akuzuari A.Z. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, i është shpallur dënim me burgim me kohëzgjatje prej 19(nëntëmbëdhjetë)viteve e 6(gjashtë) muajve dhe për veprën penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-së dhe është shqiptuar dënim unik me burgim prej 20(njëzet)vite i akuzuari Sh.K. për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK i është shpallur dënim me burgim me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite e 6(gjashtë) muaj si dhe për shkak të veprës penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-së është gjykuar me dënim burgu unik në kohëzgjatje prej 16(gjashtëmbëdhjetë)vite, i akuzuari M.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, i është shpallur dënim me burgim me kohëzgjatje prej 14(katërmëdhjetë)viteve dhe Sh.D. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK , i është shpallur dënim me burgim me kohëzgjatje 14(katërmëdhjetë)viteve.

Te akuzuarve A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D., gjykata në bazë të nenit 367 par.7 të KPPRK-së u vazhdon paraburgimin deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shume se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykim.

Të dëmtuarit S.G. dhe A.G. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit A.Z. dhe Sh.K., janë obliguar të ia paguajnë të gjitha shpenzimet sipas llogarisë përfundimtare dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 300(treqind)Euro, ndërsa të akuzuarit M.K. dhe Sh.D., obligohen të ia paguajnë të gjitha shpenzimet sipas llogarisë përfundimtare dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200(dyqind)Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesa:

-PTH-DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjkata e Apelit, aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.552/14 të datës 06.07.2016, të ndryshojë përkritazi me vendimin mbi dënimin dhe te akuzuarve të ua shqiptojë një dënimin me të lart me burg.

-Mbrojtësit e të akuzuarit A.Z., av. Y.O. dhe Sh.B.-R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit të dënimit, me propozim që Gjkata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, ta anulojë dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit Sh.K., av.B.T., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penal, kodit të drejtësisë për të mitur, me propozimin që Gjkata e Apelit, aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, ta anulojë ose te hapë dhe çështjen penale të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit M.K., av.B.N., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktive, shkeljes së ligjit penale dhe vendimit për dënim, me propozim që Gjkata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore-

DKR në Prishtinë, ta anulojë dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit Sh.D., av.S.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkëljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktive dhe vendimit të dënimit, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, ta anulojë dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

-Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar N.R., për shkak të vendimit mbi dënimin dhe vendimet e tjera, me propozim që ndaj të akuzuarve A.Z., Sh.K., M.K., Sh.D., të aprovojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë dhe të iu shqiptohen dënime më të larta.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e paraqitura, me shkresën e saj, PPA/I.nr.17/17 të dt.16.01.2017, ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, të aprovohet ndërsa të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë dhe të akuzuarve të shqiptohet dënimi me i ashpër, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D. të refuzohen si të pabazuara e ankesa e përfaqësuesit të familjes të dëmtuar të ndjerit R.G. të hudhet poshtë si e palejuar.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 390 par.1 të KPPK, caktoi seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë të akuzuarit A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D., si dhe mbrojtësit e tyre avokatët Sh.B.-R., B.T., B.N. dhe S.M., ndërsa morën pjesë përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.N.R., munguan prokurori i apelit dhe i dëmtuari A.G., si dhe mbrojtësi i dytë i të akuzuarit A.Z. avokati Y.O. edhe pse ishin të njoftuar për seancën e kolegjit dhe seanca e kolegjit në bazë të dispozitës së nenit 390 par.4 të KPPK, është mbajtur në mungesë të tyre, ngase pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit e Kosovës-DKR, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës të kësaj çështje penale juridike dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa dhe përgjigjeve në ankesa, duke sqaruar sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë pjesërisht të bazuara, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, është e pa bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Prishtinë në ankesën e saj pretendon se gjykata ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plote gjendjen faktike dhe dënimi i shqiptuar me burg nuk është adekuat me peshën e veprës penale dhe gjykata i ka marr parasysht rrethanat lehtësuese dhe renduese si moshën , gjendjen ekonomike dhe rrethanat tjera lehtësuese, mirëpo, nuk ka marr për bazë pasojat e shkaktuara nga kjo veprë penale për arsye se nga provat e administruara rezulton se të akuzuarit veprën e kanë kryer me dashje, e kjo tregon që të akuzuarit kanë prirje kriminale, rrezikshmëria shoqërore është e lartë dhe me këto dënimin nuk mund të arrihet parandalimi individual dhe ai gjeneral për arritjen e qëllimit të dënimit.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.Z., në ankesën e tyre të përbashkët pretendojnë se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.11 me të cilin është shkelur dispozita e nenit 395 të KPP, se përmbajtja e aktgjykimit dhe forma e tij është në kundërshtim me nenin 370 par.4,5,6,7,8 dhe në aktgjykim nuk janë të përfshira të dhënat e nevojshme të parapara si në nenin 365 të KPP. Në aktgjykim nuk janë vlersuar provat, për arsye se nuk janë paraqitur faktet vendimtare dhe se të akuzuarit i është shqiptuar dënimi prej 20 viteve dhe është shkelur parimi i “Reformatio in Peius”, e kjo nënkupton se ndalohet ndryshimi e vendimit gjyqësor dhe keqësimin e pozitës të akuzuarit në rastet kur paraqitet mjete juridik në dobi të akuzuarit, kjo për arsye se ankesat e PTH-DKR në Prishtinë nga Gjykata e Apelit, është deklaruar si jo lëndore për arsye se prokuroria nuk ka ushtruar ankesë mbi gjendjen e fakteve.

Ankesa pretendon se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plote, kjo për arsye se të akuzuarit A.Z. dhe Sh.K., gjate gjithë procedurës kanë deklaruar të vërtetën dhe kanë kontribuar në zbardhjen e rastit, e kjo për arsye gjykata nuk i beson të akuzuarve se në shtëpinë e të ndjerit. Edhe gjate rekonstruimit të vendit të ngjarjes, mbeti e paqarte se çka ndodhi brenda në shtëpi në momentin kur të akuzuarit Af. dhe Sh., u gjenden ballë për ballë me të ndjerin i armatosur me pushkë gjuetie, bashkëshorten e të ndjerit dhe të birin e tyre. Ankesa pretendon se nuk qëndron konstatimi si i akuzuari Af., ka shkrepur në drejtim të ndjerit R., kjo për arsye se pozita se ku ka qene i ndjeri R., nuk ka mundë të vërej të akuzuarin Af., ndërkaq i akuzuari Af., e ka vrenjtur mirë të ndjerin R., e ky arsyetim është i pabaze dhe nuk i përgjigjet gjendjes faktike. Në ankesë pretendohet se nga dispozitivi dhe arsyetimi nuk del i akuzuari Af., është zënë në befasi aktin e vjedhjes me qëllim që pasurin e vjedhur të mbajë dhe e ka përdorur dhunën, e kjo rrethane përjashton kryerjen e veprës penale të vjedhjes grabitqare dhe të grabitjes dhe i akuzuari nuk kishte vjedhur asnjë centë, e në të njëjtën kohë i akuzuari nuk ka shtënë në të ndjerin R., me qëllim që pasurinë e vjedhur të mbaje, por ka shtënë në drejtim të ndjerit R. nga frika.

Sa i përket vendimit mbi dënimin në ankesë pretendohet se vendimi është kundërligjor është shqiptuar në kundërshtim me parimin "Reformatio in Peius", dhe duke marrë parasysh të gjitha faktet dënimi është tejte i lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K., avokati B.T., në ankesë pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, i akuzuari Sh.K., është shpallur fajtor për veprën penale në rastet e rënda të vjedhjes grabitqare dhe të grabitjes dhe është dënuar me aktgjykim me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 13(trembëdhjete)vite, ndërsa me aktgjykimin e ri është shpallur fajtor për veprën e njëjtte penale dhe i është shqiptuar dënimi me burgim me kohëzgjatje prej 16(gjashtëmbëdhjetë)viteve edhe pse nuk është kryer vepra penale e grabitje dhe është kryer vepra penale e vjedhjes e mbetur në tentativë e maksimumi i dënimit duhet të jetë 5(pesë)vite. Gjykata nuk ka marrë parasysh se nuk është shkelur Ligji Penal-Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Për veprën penale mbajtja në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPP, vepra penale është përfshirë në amnisti.

Ankesa pretendon se janë shkelur edhe të drejtat të tjera mos përdorimi i laptopit, me të akuzuarin të shikojnë së bashku CD, nga vendi i ngjarjes, sheh se procesverbalet nuk janë dhënë mbrojtësve e nuk i ka lejuar procesverbalet edhe pas shpalljes së aktgjykimit, si dhe nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme për fjalën përfundimtare. Gjykata sipas propozimit nuk ka analizuar rrethanat konform gjendjes faktike dhe në përputhje me ligjin, për të bërë dallimin në mes të veprës penale të detyrimit, të vjedhjes së rendë, të grabitjes dhe të vjedhjes grabitqare.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.K., avokati B.N., në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i paqartë dhe përplot me kontradikta logjike dhe faktike e kjo benë që aktgjykimi të jete në tërësi i paqartë, e kjo bene që dispozitivi i aktgjykimit në tërësi të jete i paqarte dhe gjykata pa ndonjë lidhmëni logjike për grupin e armatosur, marrëveshjen paraprake, për privim nga jeta të ndjerit R., nuk jep ndonjë argumente lidhur me veprimet e të akuzuarit M. dhe Sh., e të cilin i kanë pritur në Fushë-Kosovë, të akuzuarit Af. dhe Sh., dhe gjykata nuk jep rendësi se i akuzuari Sh., se nga mëngët e një xhemperi i është përgatitur maska e të akuzuarve Af. dhe Sh., e të cilët të armatosur ndërmjet dritares së banjës të shtëpisë së të ndjerit R., kanë hyrë brenda, e kjo për gjykatën se e kush ka hyrë brenda për gjykatën e shkallës së parë, nuk ka pasur rendësi e kjo tregon kontradiktat dhe konfuzitetin e aktgjykimit. Sipas ankesës është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 370 par.6,7 të KPP, për arsye nuk ka lidhmëni logjike as faktike në sqarimin e qëndrimit si i akuzuari M.K., paska privuar nga jeta të ndjerin R.G. dhe ai paska qenë anëtarë i grupit të armatosur dhe kjo nuk mund të vërtetohet me asnjë provë që të mundë të nxjerrët një konkludim i tillë. Si pasojë e kësaj gjykata ka vepruar në nenin 370 par.7 të KPP. Ankesa pretendon se është shkelur ligji penal dhe gjykata zbaton nenin 256 par.1 dhe 2, duke

shtuar neni 23 të KPP. Kjo rrjedhë nga konstrukti i dispozitivit, "të akuzuarve duke vepruar si grup i armatosur", e ky fakt është qenësor i veprës penale nga par.1, pra përfshinë grupin si element i veprës penale, ndërsa par.2 me të cilin akuzohen të akuzuarit nuk fletë për grupin por vetëm për pasoja–privim nga jeta. Nga kjo rezulton se zbatimi i ligjit penal nga gjykata e shkalles së parë është tejet konfuz pa përcaktim të duhur të cilësimit ligjor të veprës penale. Gjykata nuk jep ndonjë sqarim me kontributin e të akuzuarit M. për veprën penale të cilën është shpallur fajtor. Sa i përket të akuzuarit M. nga gjendja e paraqitur, nëse e njëjta merret si e pranueshme për të akuzuarin M. kemi të bëjmë me një tjetër vepër kjo për arsye mungon përvetësimi i pasurisë.

Mbrojtësja e të akuzuarit Sh.D. në ankesën e sajë pretendon, se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale nga neni 384 par1 nën par.1.8 e lidhur me nenin 123 par.5 të KPP, për arsye aktgjykimi është mbështetur në provë të papranueshme, sepse gjykata aktgjykimi e bazon në deklaratat e Af. dhe Sh. si të bashkë pandehur e në vendimin në këto deklaratat nuk mund të bazohet. Aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitivin e nenit 370 të KPP dhe lidhur me nenin 365 par.1.5 për arsye se në dënimin e shqiptuar me burgim nuk është llogaritur koha e kaluar në paraburgim. Përveç kësaj aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale nga neni 370 par 6,7 për arsye nuk janë arsyetuar faktet vendimtare dhe i njëjti aktgjykim është përpiluar me kundërshtim me nenin 365 par1 të KPP ku nuk janë paraqitur faktet dhe rrethanat që e përbejnë figurën e veprës penale të cilat varet zbatimi i ligjit penal. Gjykata nuk jep sqarime të duhura se a kemi të bëjmë me "duks" apo me "xhemper", e nga mëngët e të cilave janë bërë maskat për të akuzuarit Af. dhe Sh. dhe gjykata nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe nuk ka analizuar kundërthëniet e mbrojtjeve të akuzuarve Af. dhe Sh.. Gjykata nuk ka eliminuar dhe nuk ka vlersuar saktësinë e provave ajo ka shkelur parimin "Reformatio in Peius", kjo për arsye pasi që lënda është kthyer në rigjykim të akuzuarve Sh.D., ka shqiptuar dënim më të lartë.

Sipas ankesës edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për arsye gjykata nuk sqaron se si i akuzuari Af. dhe i akuzuari Sh., i shndërruan mëngët e xhemperit në maska, nuk sqaron se ku kanë mbetur të akuzuarit M. dhe Sh., duke bërë roje. Nga kjo rezulton se deklaratat e të akuzuarve Af. dhe Sh., janë në kundërshtim me fazat e ndryshme të procedurës penale, e gjykata nuk jep asnjë sqarim lidhur me maskat dhe bërjen e rojeve të akuzuarve Sh. dhe M..

Nga gjendja faktike nuk rezulton se i akuzuari Sh., të ketë marr pjesë në veprën penale për të cilën është shpallur fajtor si bashkëkryerës dhe në këtë çështje penale meqenëse ekzistojnë mëdyshjet është dashur të aplikohet neni 3 par.2 të KPP. Si pasojë e shkeljeve të cekura më lartë ankesa pretendon se është shkelur ligji penal në dem të akuzuarit Sh. elementi subjektiv i bashkëkryerjes, për arsye nuk është vërtetuar me asnjë provë se i akuzuari ka bërë roje. Ankesa pretendon se edhe vendimi mbi dënimin është i

paligjshëm e sidomos ashpërsimi i tij prej 10 viteve në 14 vite dhe nuk janë vlersuar me rastin e marrjes dhe në matjes së dënimit në dispozitat e nenit 73 të KPRK –së.

Pretendimet ankimore se nuk janë respektuar dispozitat ligjore KDM, nuk qëndrojnë për arsye se i akuzuari Sh.K., në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor, mirëpo, me asnjë provë nga shkresat e lendes nuk del se ky i akuzuar madhor se ndaj tij duhet të aplikohen dispozitat e KDM, e aq më parë kur me asnjë dispozitë qoftë të KDM apo KPRK, të jetë përcaktuar se ndaj personave të kësaj moshe nuk mund të aplikohen dispozitat e KPRK-së.

Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet e paraqitura në ankesën PTH-DKR në Prishtinë, të mbrojtësve të akuzuarve A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D., në të cilën gjykata shikon sipas detyrës zyrtare, në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, e për veprat penale të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK dhe të veprës penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së e të cilat pretendime sipas vlerësimit të kolegjit penal janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto vepra penale të cekura më lartë ka paraqitur arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare se të akuzuarit A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh. D., janë kryes të veprës penale rastet e rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, të akuzuarit A.Z., Sh.K. edhe të veprës penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK, Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet e paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve lidhur me shkeljet esenciale se ekzistojnë kundërthëniet lidhur me faktet vendimtare nuk qëndrojnë dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe të plota, e këto mbështeten në pranimin e vetë të akuzuarve A.Z. dhe Sh.K., të cilët pranojnë se i akuzuari M. i kishte thirrë me telefon që të vije në Fushë-Kosovë, të pompa e benzinës “NN” dhe të akuzuarit Af. dhe Sh., marrin një taksì prej Suhareke, e ftojnë taksistin L.A. që prej Suhareke të dërgojë në një fshat afër Fushë-Kosovës dhe pasi që të akuzuarit futen në taksì, i akuzuari Sh. ndalet për një kohë të shkurtër zbrit për një kohë të shkurtër dhe shkon në fshatin Sllapuzhan dhe aty merr dy revole dhe revolen e kalibrit 7.65 mm, i akuzuari Sh. ia jep të akuzuarit Af., ndërsa revolen e kalibrit 6.35 mm, e mban për vete, pastaj kthehet në automjetin e taksistit L.A. dhe nisen dhe arrijnë tek pompa e benzinës “NN” dhe aty takohen me të akuzuarit M., Sh. dhe I.S., i cili gjendet në arrati e këto fakte i pranojnë edhe të akuzuarit M. dhe Sh. se janë takuar me të akuzuarit Af. dhe Sh.. Këto mbështeten edhe gjatë ballafaqimit në mes të akuzuarve A.Z. dhe M.K. dhe të ballafaqimit të akuzuarve Sh. dhe M., ku në tersi vërtetohet se të akuzuarit në grup e me marrëveshje paraprake i ndajnë në mes veti veprimet të cilat duhet të ndërmarrin dhe koordinohen dhe sipas marrëveshjes i akuzuari Af. me revolen të kalibrit 7.65 mm dhe i akuzuari Sh., me revolen 6.35 mm, shkojnë në shtëpinë e të ndjerit R.G., ndërsa të akuzuarit M. dhe Sh.,

bëjnë roje dhe nuk hyjnë brenda në shtëpi për arsye dikush mos ti njih dikush prej fshatarëve të fshatit ... dhe të mos zbulimit të tyre si kryes të veprës penale.

Këto fakte mbështeten nga vetë deklaratat e të akuzuarve dhe gjatë ballafaqimit të tyre se të akuzuarit M. dhe Sh. bëjnë roje, ndërsa i akuzuari Sh. ju pregaditë nga një maskë nga krahët e xhemperit, të cilët maskohen të akuzuarit Af. dhe Sh., i vendosin në kokat e tyre dhe vendosjen e gajbave, nëpërmes dritares së banjës hynë brenda në shtëpi të maskuar dhe të armatosur e me qellim grabitje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk mund të konsiderohet provë e papranueshme ballafaqimi i kryer në mes të akuzuarve M. dhe Sh., me të akuzuarit Af. dhe Sh., për arsye kjo është e rregulluar me dispozitat e nenit 347 par.2 (i vjetëri neni 373 KPP), është paraparë instituti i ballafaqimit, në rastet kur deklaratimet e të bashkakuzuarve për rrethanat e njëjta ndryshojnë si rasti në çështjen penale konkrete, e me qellim të vërtetimit të fakteve dhe gjykata e ka mbështet vendimin në ballafaqimin në mes të bashkakuzuarve dhe ky institut juridik në tersi dallon nga dëshmitaret e privilegjuar e cila mbështetet në ankesë, se vendimi nuk mund të mbështet në dëshminë e të bashkëpandehurve, sipas dispozitës 123 par.5 të KPP (i vjetri 159 par.3 KPP), për arsye se tani kemi të bëjmë syzim e të bashkakuzuarve e cila është provë e pranueshme dhe nga syzomi i kryer në mes të bashkakuzuarve të cekur më lartë Gjykata e shkallës së parë ka nxjerr konkludim të drejtë se edhe të akuzuarit M. dhe Sh., kanë marr pjesë dhe kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK.

Se të akuzuarit kanë vepruar në bashkëkryerje, kjo mbështetet në deklaratën e A.G., djali i të ndjerit R., i cili në shqyrtimin gjyqësor deklaron se ka qenë në shtëpi duke punuar në kompjuter dhe aty ka vërejtur dy persona të maskuar me revole në dore, e këtë e vërteton edhe dëshmitarja S.G., e cila deklaron se ka vërejtur dy persona të maskuar dhe njëri prej tyre ka drejtuar revolen në drejtim të sajë. Përveç kësaj të akuzuarit janë kryes të veprës penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, mbështet në deklaratat e dëshmitarëve të cekur më lartë se të akuzuarit kanë pasur qellim grabitjen dhe pasi janë hetuar se kishin hyrë në shtëpinë e të ndjerit dhe pas kërcënimit me revole nga të akuzuarit Af. dhe Sh., ndaj dëshmitarëve Ar. dhe S., me të dëgjuar se po ndodhe grabitja në shtëpinë e të ndjerit R., i njëjti me qellim të mbrojtjes pasurisë e tij si e drejtë e garantuar e çdo individ, e merr pushkën e gjuetisë ndërsa të akuzuarit pasi që do të zbulohen, i akuzuari Sh. mundohet të ikë, ndërsa i akuzuari Af. pasi që e sheh të ndjerin në katin e dytë dhe del në terasën e shtëpisë dhe pasi që e sheh të ndjerin R., nga revolja shkrep në drejtim të tij dhe nga shkrepje si pasoje nga plaga e marrë në gjoks i ndjeri R., ndërron jetë në QKUK në Prishtinë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, rreth konkludimit se të akuzuarit A.Z., Sh.K., M.K., Sh.D., se kanë kryer veprën penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256

par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, e të akuzuarit A.Z. e Sh.K., kanë kryer veprën penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së mbështeten në raportin e autopsisë MA 10-213, të datës 3.08.2010, të kryer nga eksperti Dr.M.G., MD, DSC dhe si shkak i vdekjes pas ekzaminimit të kryer në trupin e të ndjerit, është e shtëna me armë në gjoks të ndjerit R., në provat materiale, shikimi në vendin e ngjarjes, rikonstruimi në vendin e ngjarjes dhe nga CD, nga foto dokumentacioni dhe nga dy revolet njëra e kalibrit 7.65 mm të cilën e ka përdorur dhe me të cilën ka shkrep në drejtim të ndjerit R.G., i akuzuari A.Z. dhe revolen tjetër të kalibrit 6.35 mm, e cila ka qenë e dedikuar për përdorim e të cilat të dy revolet i ka siguruar Sh.K., ndërsa revolen 7.65 mm, e të cilën e ka përdorur i akuzuari të njëjtën e ka pasur në posedim. Se të akuzuarit janë kryes të veprave penale të cilët janë shpallur fajtor, ky fakt mbështetet edhe nga raporti i njësisë teknike të kriminalistike të datës 03.09.2010, pas analizës me anë të llupave janë konstatuar gjurmët e vijave papilare të akuzuarit Af. dhe Sh., e të fiksuara në bazë të identifikimit dhe të krahasimit nga data bazë e të dhënave të kartelave 10(dhjetë gishtorë) të AFISIT-it e të cilët janë skanuar dhe ato përputhen me shenjat e gishtërinjve të akuzuarve A.Z., gjurma e fiksuar F6, F8 të cilat shenja i përgjigjen gishtit tregues dhe gishtit të madhe, ndërsa gjurmët e fiksuara F5, i perket shenjës së shuplakës së akuzuarit A.Z., ndërsa gjurma e fiksuar F3, i përgjigjet dorës së majtë të akuzuarit Sh.K..

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve A.Z.. Sh.K. dhe Sh.D., se është shkelur ndalesa “Reformatio in Peius”, nga neni 395 të KPP, nuk qëndrojnë për arsye se ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, është jo lëndore nuk nënkupton se dënimi nuk mundë të ashpërsohet, kjo për arsye sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi PAKR.nr.440/2015 të datës 09.10.2014, është anuluar sipas ankesave të mbrojtësve edhe sipas detyrës zyrtare dhe ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, ka mbetur e pa vlerësuar (e pa shqyrtuar), pra ankesa ka ekzistuar dhe kjo nënkupton se Gjykata e shkallës së parë, meqë ka ekzistuar ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, nuk ka qenë e kufizuar me ndalesën “Reformatio in Peius”, nga neni 395 të KPP, kur të akuzuarve ju ka shqiptuar dënime me të ashpra.

Pretendimet ankimore se vepra penale, mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK, është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale është i paqëndrueshëm lidhur me të akuzuarin Sh.K., kjo për arsye se sipas nenit 4 të ligjit për amnistinë për veprat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor e në çështjen penale konkrete i akuzuari Sh.K., ka qenë bashkë kryes në veprën penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, vepra penale e cekur më lartë ku i akuzuari Sh.K., ka pasur revolen 6.35mm, e cila ka qenë dedikuar për përdorim, i njëjti ka pasur kontribut në kryerjen e

veprës penale ku është privuar nga jeta i ndjeri R.G., kjo vepër penale nuk mund të përfshihet në amnisti si pretendon ankesa.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të akuzuarit të cekur më lartë kanë kryer vepër penale të cilën janë shpallur fajtor mbështeten se i ndjeri R.G., është privuar nga jeta me armë zjarri nga shkrepja e të akuzuarit A.Z., të cilën e pranon edhe vetë i akuzuari e ky fakt mbështetet edhe nga deponimet e dëmtuarve e të cilët kanë qenë edhe dëshmitar okular kur ka ndodhë në shtëpinë e tyre të A.G.t dhe S.G.t.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga ajo që është cekur më lartë aktgjykimi është përpiluar në pajtim me dispozitën e neni 365 të KPP, se i njëjti është bazuar në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe janë dhëne arsyet e qarta dhe të plota si parasheh neni 370 të KPP, e nga kjo rezulton se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet e pretenduara ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe në ankesën e të akuzuarit Sh.K., nga neni 384 par.1 nën par 1.12 të KPP.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesave lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vlerëson se ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë të paqëndrueshme kjo për arsye i akuzuari M.K., me të akuzuarin A.Z., janë njohur edhe më herët edhe në Austri, ndërsa me të akuzuarin Sh. dhe I.S., janë njohur mire në mes veti. Gjykata drejtë ka vërtetuar se i akuzuari M., e ka ftuar me telefon të akuzuarin Af., i cili bashkë me të akuzuarin Sh., me taksitë e dëshmitarit L.A., nisen për në Fushe-Kosovë, e me qëllim të kryerjes së veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK dhe rrugës me kërkesën e të akuzuarit Sh. ndalen dhe i akuzuari në fshatin Sllapuzhan, ku i merr dy revole dhe revolen e kalibrit 7.65 mm, ia jep në posedim të akuzuarit Af., ndërsa revolen e kalibrit 6.35 mm, e mban për veti dhe pasi arrijnë në pompën e benzinës "NN", bashkohen me të akuzuarit M.K., Sh.D. e I.S. dhe aty formohet grupi i armatosur si dhe aty fillojnë të bashkëveprojnë në mes veti me ndarjen e detyrave prej secilit prej tyre dhe sipas marrëveshjes paraprake e me rekomandimin e të akuzuarve M. dhe Sh., e me qëllim që nëse eventualisht mund të zbulohen që të mos mund të identifikohen për arsye se të akuzuarit M. dhe Sh., janë të njohur për fshataret e fshatit ... dhe pas bisedës paraprake datën 3.08.2010, rreth orës 01 pas mesnate, vendosin që në shtëpinë e të ndjerit R.G., të shkojnë të armatosur me qëllim grabitje të akuzuarit Sh. dhe Sh., e bashkë me ta edhe të akuzuarit M. dhe Sh., ku i akuzuari Sh., nga mëngët e xhemperit i përgatitë në formë të maskave dy maska të cilat në kokë i vendosin të akuzuarit Af. dhe Sh. dhe me vendosjen e gajbeve nëpërmjet dritares së banjës së shtëpisë hynë brenda në shtëpi, ndërsa të akuzuarit M. dhe Sh., sipas marrëveshjes paraprake bëjnë roje. Pasi të akuzuarit Af. dhe Sh., të armatosur hynë brenda në shtëpi në dhomë takohen me djalin e të ndjerit R., A.G. dhe armen e drejton nga ai duke kërkuar të holla dhe në momentin kur dëgjohet zhurma nga dhoma tjetër del bashkëshortja e të ndjerit Sabrije dhe i akuzuari Sh. nëpërmjet sallorit largohet bashkë me revolen e tij,

ndërsa i akuzuari Af., kalon në katin e dytë të shtëpisë del në terasë ku takohet me të ndjerin R., i cili kishte pasur pushkën e shtëpisë e me qëllim të mbrojtjes pasurin e tij dhe i akuzuari menjëherë shkrep në drejtim të tij dhe e godet në gjoks dhe pas plagës dhe sipas ekspertizës të kryer pasi janë hapur kavitetet si pasojë nga e shtëna me revole 7.65 mm, i ndjeri edhe ka ndërruar jetë.

Nga kjo rezulton se fillimisht të akuzuarit janë njohur mire njëri me tjetrin, kanë formuar grupin e armatosur me qëllim të grabitjes apo vjedhjes grabitqare dhe pasi takohen merren vesh njëri me tjetrin e me qëllim të akuzuarit M. dhe Sh., të mos identifikohen shkojnë te rrethoja e oborrit të shtëpisë dhe nëpërmjet të gajbave të vendosura e të cilat i rregulluan bashkërisht të gjithë të akuzuarit i kryen veprimet inkriminuese të përshkruara më lartë dhe kjo gjendje faktike e vërtetuar është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit dhe në këtë drejtim ankesat e mbrojtësve të akuzuarve sipas kësaj baze juridike janë të paqëndrueshme.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve që është shkelur ligji penale 385 par.1 të KPP nuk qëndrojnë, për arsye se grupi mund të formohet edhe përkohësisht dhe mjafton që anëtarët të jenë të lidhur me marrëveshje të përbashkët që të kryejnë aktivitete kriminale e në çështjen penale për të kryer veprën penale rastet e rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, e që marrëveshja paraprake ka ekzistuar A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D. dhe ekziston lidhja objektive në mes të akuzuarve të cekur më lartë që të ndërmarrin veprimet të njëjtën kohe dhe të njëjtin vend në shtëpinë e të ndjerit R., ku gjate kryerjes së grabitjes apo vjedhjes grabitqare e privuar nga jeta i ndjeri R., e si rezultat i marrëveshjes në mes të akuzuarve, e përveç kësaj ka ekzistuar edhe lidhja subjektive se të akuzuarit kanë ditur për njëri tjetrin se janë duke vepruar bashkërisht, se të akuzuarit Sh., M. dhe Sh., kanë ditur se i akuzuari Af., ka qenë i armatosur dhe pasi që janë hetuar se do të kryejnë veprën penale të cekur më lartë i ndjeri i cili e ka pasur pushkën e gjuetisë me qëllim që të mbrojtë pasurin e tij dhe pasi që i akuzuari Af., e vëren të ndjerin R., menjëherë shkrep në drejtim të tij dhe me predhë e godet me gjoks, e si pasojë e kësaj i ndjeri edhe vdes. Nga kjo rezulton se Gjykata e Apelit, ndryshoj cilësimin juridik të veprës penale dhe gjeti se të akuzuarit kanë kryer veprën penale rastet e rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, për arsye në paragrafin 1 të nenit 256 të KPK, janë paraqitur elementet e veprës penale për të cilët të akuzuarit, janë shpallur fajtor ndërsa në paragrafin 2 përshkruhen vetëm pasojat e veprës penale dhe me ricilësimin e veprës është evituar shkelja e ligjit penal. Sa i përket veprës penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Ankesa e përfaqësuesit e palës së dëmtuar avokatit N.R., është hudhër poshtë e palejuar kjo për arsye sipas dispozitës së nenit 381 par.3 të KPP, ankesë ndaj aktgjykimit për vendimet e gjykatës lidhur me sanksionet penale mund të ushtrohen për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual dhe veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik, ndërsa veprat penale rastet e rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare nga neni 256 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 23 të KPK, hynë në grupin e veprave penale kundër pasurisë ndërsa vepra penale mbajtja me pronësi të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK, hynë në grupin e veprave penale të armeve dhe për këto shkaqe ankesa e përfaqësuesit e palës së dëmtuar është hudhur poshtë si e palejuar.

Pretendimet ankimore të paraqitura më ankesën e PTH-DKR në Prishtinë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, janë të paqëndrueshme, për arsye pretendimi ankimor se vepra penale është kryer me dashje direkte dhe gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar pasojën e veprës penale, nga kjo rezulton se këto pretendime ankimore janë elemente të veprës penale e në mungesë të ndonjë rrethane renduese apo posaçërisht renduese e të cilat nuk janë paraqitur në ankesë.

Gjykata e Apelit ankesën e paraqitur nga ana PTH-DKR në Prishtinë, e ka refuzuar si të pa bazuar. E sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, në masë të duhur i ka vlerësuar të gjitha rrethanat si ato renduese dhe ato lehtësuese, me rastin e marrjes dhe matjes së dënimit, me vlerësimin e rrethanave të përgjithshme mbi matjen e dënimit të paraparë si në nenin 73 të KPRK, e duke marrë parasysh se vepra penale është kryer për shkak të lakmisë dhe me pasoja të rënda, e me privimin e të ndjerit, e të dy vlera mbrojtëse privimi nga jeta dhe mbrojtja e pasurisë gëzojnë mbrojtje penale juridike si vlera më të madhe e mbrojtjes penale-juridike, dënimet e shqiptuara të akuzuarve A.Z., Sh.K., M.K. dhe Sh.D., është në proporcion me peshën e veprave penale të kryera dhe me shkallën e përgjegjësisë penale-juridike të tyre dhe dënimet e këtilla të shqiptuara do ti shërbejnë preventives individuale që ti parandalojë të akuzuarit nga kryerja e veprave penale të këtilla dhe

të ngjashme, si dhe ti shërbejë preventives së përgjithshme që ti parandalojë të tjerët në kryerjen e veprave penale të këtilla apo të ngjashme dhe pritët të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Me aprovimin e pjeserishëm të ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, refuzimin e ankesës të PTH-DKR në Prishtinë dhe të hudhjes poshtë të ankesës të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 401, 403 par.1 dhe 400 të KPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.5/2017, me dt.06.02.2017

Procesmbajtës,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Abdullah Aliu

Kryetari i Kolegjit,

Vahid Halili